

UDHËZIM
Nr. 11, datë 2.4.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PËRMBAJTJES DHE TË FORMËS SË SUPLEMENTIT TË DIPLOMËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës, si dokument shoqërues, i pandarë dhe që lëshohet së bashku me diplomën nga ana e institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato “Master ekzekutiv” të ciklit të tretë.

2. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

3. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës të çdo institucioni të arsimit të lartë, përcaktohen në statutin e tyre dhe miratohen nga Senati Akademik përkatës, hartuar sipas Modelit Kombëtar të Suplementit të Diplomës, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi si aneksi 1.

4. Suplementi i diplomës duhet të përmbajë 8 (tetë) seksione si më poshtë:

- a) “1. Të dhëna identifikuese për mbajtësin e diplomës”;
- b) “2. Informacion identifikues mbi kualifikimin”;
- c) “3. Informacion mbi nivelin dhe kohëzgjatjen e kualifikimit”;
- ç. “4. Informacion mbi programin e studimit të përfunduar dhe rezultatet e arritura”;
- d) “5. Informacion mbi përdorimin e kualifikimit të fituar”;
- dh) “6. ‘Informacion shtesë’ ku përfshihet edhe ‘Numri rendor i studentit në regjistrin bazë/ themeltar’; ‘Numri rendor i regjistrimit të diplomës në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave të IAL-së përkatëse’;
- e) “7. Certifikimi i suplementit”;
- ë) “8. Informacion për sistemin kombëtar të arsimit të lartë”.

5. Informacioni për sistemin kombëtar të arsimit të lartë, duhet të pasqyrojë organizimin dhe funksionimin e tij në momentin që lëshohet suplementi i diplomës. Ai duhet të jetë i njëjtë për të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë të vendit.

6. Institucionet jopublike të arsimit të lartë që i organizojnë studimet jo sipas modelit shqiptar, duhet të përshijnë në suplementin e diplomës edhe informacionin mbi ekuivalentimin e rezultateve të arritura në programin përkatës të studimit me sistemin kombëtar të vlerësimit.

7. Informacioni në suplementin e diplomës është unik për çdo Institucion të Arsimit të Lartë për sa i përket formës dhe përmbajtjes.

8. Të dhënat personale në suplementin e diplomës janë konfidenciale.

9. Përmbajtja e suplementit të diplomës duhet të jetë në 2 (dy) gjuhë: shqip dhe anglisht. Në rastet kur programi i studimit zhvillohet në Republikën e Shqipërisë nga një institucion i huaj i arsimit të lartë ose në rastin e diplomave të përbashkëta (të dyfishta ose të shumëfishta) ndërmjet një institucioni shqiptar të arsimit të lartë dhe një ose disa institucioneve të huaja të arsimit të lartë, përmbajtja e tij lëshohet në gjuhën angleze dhe në gjuhën e lëshimit të diplomës së përbashkët (ndër 4 gjuhët e tjera kryesore të Bashkimit Evropian: frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht). Në çdo rast, përmbajtja e suplementit të diplomës, në të gjitha gjuhët, duhet të jetë e njëjtë. Për institucionet e huaja të arsimit të lartë që operojnë në Republikën e

Shqipërisë në përmbajtjen e suplementit të diplomës përfshihet edhe informacioni për vendin e ofrimit të studimeve, përkatësisht në germën “dh”, të pikës 4, të këtij udhëzimi.

10. Suplementi i diplomës, i lëshuar njëkohësisht së bashku me diplomën, është pa pagesë për të gjithë të diplomuarit. Në rast se mbajtësi i tij e humbet suplementin e diplomës, ai mund të kërkojë rilëshimin e suplementit të diplomës, përkundrejt një tarife të miratuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë përkatës.

11. Suplementi i diplomës nuk e zëvendëson diplomën që jepet në përfundim të programit të studimit.

12. Institucioni i Arsimit të Lartë duhet të përcaktojë në aktet e brendshme të ushtrimit të veprimtarisë së saj, procedurat për përgatitjen, certifikimin, administrimin dhe lëshimin e suplementit të diplomës, në zbatim të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

13. Udhëzimi nr. 7, datë 18.2.2009, “Për suplementin e diplomës”, shfuqizohet.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini



ANEKS 1

Suplementi i Diplomës/Diploma Supplement

1. Të dhëna identifikuese për mbajtësin e kualifikimit / Information identifying the holder of the qualification	
1.1 Mbiemri/at / Last name(s)	1.2 Emri/at / First name(s)
1.3 Datëlindja (dd.mm.vvvv) / Date of birth (dd/mm/yyyy)	1.4 Numri i Matrikullimit / Student identification number or code
2. Informacion identifikues mbi kualifikimin / Information identifying the qualification	
2.1 Emërtimi i kualifikimit të dhënë (në gjuhën origjinale) / Name of qualification	2.2 Fusha/t kryesore e studimit e kualifikimit / Main field(s) of study for the qualification
2.3 Emri dhe statusi i institucionit që lëshon diplomën (në gjuhën origjinale) / Name and status of awarding institution	2.5 Gjuha/ët e përdorur/a në mësimdhënie/provime / Language(s) of instruction/examination
2.4 Emri dhe statusi i institucionit (nëse është i ndryshëm nga pika 2.3), që ofron studimet (në gjuhën origjinale) / Name and status of institution (if different from 2.3) administering studies	
3. Informacion mbi nivelin dhe kohëzgjatjen e kualifikimit / Information on the level and duration of the qualification	
3.1 Niveli i kualifikimit / Level of the qualification	3.2 Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit në kredite ECTS dhe vite akademike/ Official duration of programme in ECTS credits and years

	Kushti/et e hyrjes në programin e studimit / Access requirements(s)		
3.3			
4. Informacion mbi programin e studimit të përfunduar dhe rezultatet e arritura / Information on the programme completed and the results obtained			
4.1	Forma e studimit / Mode of study 	4.2	Rezultatet e të nxënit të parashikuara për programin e studimit / Programme learning outcomes
4.3	Elementet e programit, kreditet ECTS të fituara dhe notat e marra / Programme details, individual credits gained and grades/marks obtained 		
4.4	Sistemi i notave dhe, nëse disponohet, tabela shpërndarëse e tyre / Grading system and, if available, grade distribution table 	4.5	Klasifikimi i përgjithshëm i kualifikimit (në gjuhën origjinale) / Overall classification of the qualification
5. Informacion mbi përdorimin e kualifikimit të fituar / Information on the function of the qualification			
5.1	Mundësia për studime të mëtejshme / Access to further study 	5.2	Mundësia për të ushtruar një profesion të rregulluar (nëse aplikohet për kualifikimin përkatës) / Access to a regulated profession (if applicable)
6. Informacion shtesë / Additional information			
6.1	Informacion shtesë / Additional information 	6.2	Burime të tjera informacioni / Further information sources
7. Certifikimi i suplementit / Certification of the supplement			
7.1	Data (dd.mm.vvvv) / Date (dd/mm/yyyy) 	7.2	Firma / Signature
7.3	Në cilësinë e / Capacity 	7.4	Vula zyrtare / Official stamp or seal
8. Informacion për sistemin kombëtar të arsimit të lartë / Information on the national higher education system			

Sistemi shqiptar i arsimit të lartë	Albanian Higher Education system
Sistemi i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, rregullohet me ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e tij. 8.1 Organizimi dhe llojet e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) Llojet e IAL-ve janë: 1. Universitet; 2. Kolegj universitar; 3. Akademi; dhe 4. Kolegj profesional i lartë. IAL-të janë të organizuara në institucione publike, jopublike dhe publike të pavarura, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ato ofrojnë programe të licencuara të studimeve të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS), për të cilat lëshojnë diploma pas akreditimit të institucionit dhe programit të studimit. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite ECTS. 8.2 Llojet e programeve të studimit dhe të diplomave Programet e studimeve në IAL organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6–8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë dhe programe me karakter profesional, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore. IAL-të ofrojnë programe studimi në cikle të ndryshme në varësi të llojit të institucionit, si dhe programe të formimit të vazhduar, në fushat ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore. Universiteti ofron programe studimi të niveleve 5–8 të KSHK. Kolegji Universitar ofron programe studimi të niveleve 5–7 të KSHK-së. Akademia ofron programe studimi të niveleve 5–8 të KSHK-së. Kolegji Profesional i Lartë ofron programe studimi të nivelit 5 të KSHK-së. 8.3 Licencimi dhe akreditimi 8.3.1 Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i IAL-ve Hapja e një IAL-je, mbyllja dhe ndarja/bashkimi i një institucioni me një institucion tjetër të arsimit të lartë bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, sipas standardeve përkatëse të miratuara	The Higher Education System in the Republic of Albania is regulated by Law no. 80/2015 dated 22.07.2015 “On Higher Education and Scientific Research in the Institutions of Higher Education of the Republic of Albania” and respective bylaws for its implementation. 8.1 The organization and types of of Higher Education Institutions (HEIs) The types of institutions of higher education are: (1) University, (2) University College, (3) Academy and (4) Higher Professional College. HEIs are organized as public, non-public and independent public institutions, as by provisions of the aforementioned law. They offer licensed study programs, organized in modules and graded in credits ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System), for which degrees are issued after the accreditation of the institution and of the study program. The normal quantity of credits accumulated by a student during an academic year is 60 credits ECTS. 8.2 Types of study programs and degrees awarded The study programs offered by the HEIs are organized in three consecutive cycles: the first cycle, the second cycle and the third cycle, with reference to levels 6-8 of the Albanian Qualifications Framework (AQF). The higher education institutions offer also study programs with a professional character, with reference to 5th level of the Albanian Qualifications Framework, in those fields of educations where they meet the criteria and fulfill the state standards. The HEIs offer study programs in different cycles depending on the type of the institution, as well as lifelong learning programs in the fields where they meet the criteria and fulfill the state standards. A university offers study programs of 5th – 8th AQF level. A University College offers study programs of 5th – 7th AQF level. An Academy offers study programs of 5th – 8th AQF level. A Higher Professional College offers study programs of 5th AQF level. 8.3 Licensing and accreditation 8.3.1 Licencing, closure and reorganization of a HEI The HEIs are licensed, closed and separated/merged based on a Decree of the Council of Ministers (DCM), upon a proposal of the minister responsible for the education, according to respective standards approved by a

me VKM. IAL fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë. Një IAL përfundon veprimtarinë e tij akademike, të përcaktuar në misionin e tij, vetëm në fund të vitit të akademik. 8.3.2 Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin, kur plotësohen kriteret bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të lartë, bazuar në vlerësimin e nevojave për aftësi në tregun e punës. Pas një cikli të plotë studimi, IAL-ja mund të riorganizojë vetë programet e studimit deri në masën 20% të përmbajtjes së tyre dhe njofton për këtë ministrinë përgjegjëse për arsimin. IAL-të e një prej shteteve të Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë mund të ofrojnë programe studimi ose formime profesionale të larta. Këto programe duhet të jenë të akredituara në shtetin e origjinës dhe të ofrohen në institucione shqiptare të akredituara të arsimit të lartë, pas miratimit të tyre nga ministri përgjegjës për arsimin. Realizimi i programit kryhet me të njëjtat standarde, modalitete dhe personel akademik siç zhvillohet në vendin e origjinës të institucionit të huaj. IAL-ja shqiptare ka përgjegjësi për plotësimin e standardeve dhe realizimin e procesit akademik. Hapja e këtyre programeve u nënshtrohet paraprakisht procesit të vlerësimit dhe të njohjes nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Bordi i Akreditimit, në përputhje me Kodin e Cilësisë, si dhe detyrimet e tjera ligjore. 8.3.3 Akreditimi Sistemi i akreditimit të programeve të studimit është në funksionim që prej vitit 1999. ASCAL-ja, person juridik publik, është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL-ja është agjenci e afiliuar e ENQA-së. Në kuadër të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, ASCAL-ja bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me agjenci homologe, pjesë të Rrjetit Europian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) Akreditimi i parë institucional dhe ai i programeve kryhen përpara lëshimit të diplomave të para nga IAL-ja. Akreditimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit. Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet. Informacion konkret dhe zyrtar për institucionet e licencuara dhe të akredituara gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë	DCM. The HEI begins its activity only after the order of the minister responsible for the education is issued. A HEI terminates its academic activities, defined in its mission, only at the end of an academic year. 8.3.2 Licensing, closure and reorganization of study programs The licensing, closure and reorganization of study programs is approved by the minister responsible for the education, in case the criteria defined by legislation framework in force are met, upon the request of a HEI and based on an assessment of the needs for skills in the labor market. After a full cycle of study, HEI itself may reorganize the study programs up to 20% of their content and informs the ministry responsible for education for it. HEIs from European Union, United States of America, Canada and Australia may offer study programs or higher professional trainings. These study programs should be accredited in the country of origin and be offered by accredited Albanian HEIs, after the approval by the minister responsible for education. The program is offered with the same standards, modalities and academic staff, as it is offered in the country of origin of the foreign institution. The Albanian HEI is responsible for the fulfillment of the standards and accomplishment of the academic process. The licensing of these program has to undergo preliminarily to an evaluation and recognition process by the Agency for Quality Assurance in Higher Education (AQAE) and Accreditation Board, in compliance with Quality Code, and other legal obligations as well. 8.3.3 Accreditation The accreditation system of study programs has been set up since 1999. AQAE, a public legal body, is responsible for quality assurance in higher education. AQAE is an affiliated agency of ENQA. AQAE cooperates with other agencies, members of European Network for Quality Assurance (ENQA), in the framework of external evaluation of the quality. The first institutional accreditation and first program accreditation are conducted before the first diplomas are issued by a HEI. The institutional accreditation precedes the accreditation of the study programs. The validity of every institutional accreditation and related study programs cannot last more than 6 years. Concrete and official information on licensed and accredited HEIs is available on the official website of the Ministry of Education, Sports and Youth
--	--

(www.arsimi.gov.al), si edhe në faqen zyrtare të ASCAL (www.ascal.al).

8.4 Pranimi në arsimin e lartë

Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit me karakter profesional (*short cycle*) dhe në programet e integruara të ciklit të dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm. Hyrja në arsimin e lartë realizohet përmes një aplikimi *online* në nivel kombëtar.

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;
- b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM-në për vitin përkatës akademik.

Kandidatët vlerësohen me pikë në sistemin *online*, bazuar në plotësimin e kriterëve të vendosura për pranimin në programin përkatës të studimit nga vetë IAL-ja, vlerësimi që kanë pasur në arsimin e mesëm dhe programit ku kanë aplikuar, bazuar në sistemin meritë–preferencë.

Pranimi i kandidatëve në të gjitha programet e studimit të arsimit të lartë, kur studimet e mëparshme janë kryer jashtë vendit, bëhet pas njësimi të diplomës/certifikatës në Republikën e Shqipërisë dhe dorëzimit të dokumentin përkatës të njësimi, së bashku me dokumentet e tjera përkatëse të aplikimit pranë IAL-së.

Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, diplomave/certifikatave të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin/Qendra e Shërbimeve Arsimore.

8.5 Organizimi dhe struktura e programeve të studimit

Studimet në arsimin e lartë kryhen normalisht me kohë të plotë. Për programet e studimit me karakter profesional (*short cycle*), programet e studimit “Master profesional” dhe programet e studimit “Master ekzekutiv” mund të kryhen dhe me kohë të zgjatur. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.

8.5.1 Programet e studimit me karakter profesional (*short cycle*)

Programet e studimit me karakter profesional (*short cycle*), pas arsimit të mesëm, ofrohen me 60 ose 120 kredite ECTS, respektivisht me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike dhe i përkasin nivelit 5 të KSHK-së. Në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer.

8.5.2 Studimet e ciklit të parë

(www.arsimi.gov.al), and on the official website of the AQAHE (www.ascal.al).

8.4 Admission in Higher Education

The admission to the first cycle study programs, study programs with professional nature (*short cycle*) and integrated study programs of the second cycle is possible for any candidate who has successfully completed the secondary education cycle. Entry into higher education is achieved through an online application at the national level.

The application is open to all candidates who have successfully completed secondary education and meet the following conditions:

- a. are equipped with the legal documentation of completion of secondary education;
- b. meet the criterion of the average grade, defined by DCM for the respective academic year.

Candidates are evaluated with points on the online system based on the criteria met set for admission to the respective study program by HEIs themselves, on the evaluation they have had during the secondary education and the program they applied, based on the merit-preference system.

The admission of candidates in all higher education study programs, when the previous studies are conducted abroad, is done after recognition of respective diploma / certificate in the Republic of Albania and submission of the relevant act of recognition together with other relevant application documents to the HEI.

In the Republic of Albania, the institution responsible for official recognition diplomas / certificates issued abroad is the ministry responsible for Education / Center Educational Services.

8.5 Organization and structure of study program

Studies in higher education are normally offered in full time mode. Study programs with professional nature (*short cycle*), “Professional master” and “Executive master” study programs can be offered in prolonged mode of study. Study programs that give the rights to exercise a regulated profession can be offered in full time mode of study only.

8.5.1 Study programs with professional nature (*short cycle*)

The study programs with professional nature (*short cycle*), after secondary education, are offered with 60 or 120 ECTS credits, respectively with 1- or 2-years duration, and belong to 5th AQF level. At the end, a “Professional Certificate” or “Professional Degree” is issued respectively in the field of education completed.

8.5.2 First cycle studies

The first cycle study programs, are organized in not less than 180 ECTS credits, normal duration of

Programet e ciklit të parë të studimit, organizohen me jo më pak se 180 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe i përkasin nivelit 6 të KSHK-së.

Pranimi në këto programe studimi është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. IAL-të mund të vendosin edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga IAL-ja dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.

8.5.3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë

Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, realizohen me 300 ose 360 kredite ECTS dhe kohëzgjatje normale respektivisht 5 dhe 6 vite akademike, i përkasin nivelit 7 të KSHK-së dhe ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë e arkitekturës. Me VKM mund të përcaktohen fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve.

Pranimi në këto programe studimi është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. IAL-të mund të vendosin edhe kriteret shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga institucioni i arsimit të lartë dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Studimet në këto programe përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer.

8.5.4 Programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimi të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.

8.5.4.1 Programet e studimeve “Master i shkencave” dhe “Master i arteve”

Programet “Master i shkencave” apo “Master i arteve”, të cilat pajisin të diplomuarit, respektivisht, me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar apo njohuri

three academic years and belong to 6th AQF level.

The admission in these study programs is possible for each candidate who has successfully completed a secondary education cycle and meets the average grade requirement, defined yearly by DCM. HEIs can decide additional admission criteria for the selection of the candidates, which are publicly announced by HEI and are made available to the Center for Educational Services (CES) and to the ministry responsible for education.

At the end of the first cycle study programs, the “Bachelor” degree is issued, in the field of the study completed.

8.5.3 Second cycle integrated study programs

Second cycle integrated study programs are offered with 300 or 360 ECTS credits, normal duration of studies of 5 and 6 academic years, belong to 7th AQF level and are offered in the fields of law, medicine, dentistry, pharmacy, veterinary and architecture. The Council of Ministers may define other fields where integrated study programs may be offered.

The admission in these study programs is possible for each candidate who has successfully completed the secondary education cycle and meets the average grade requirement defined yearly by DCM. HEIs can decide additional admission criteria for the selection of the candidates, which are publicly announced by HEI and are made available to the Center for Educational Services (CES) and to the ministry responsible for education.

The studies in these programs are finalized with a thesis and at the end a “Master of science” degree in the respective field of the study completed is issued.

8.5.4 Study programs of the second cycle “Master of science”, “Master of arts” and “Professional master”

The admission in the second cycle of studies is possible for the candidates who have finished a first cycle study program and meet the admission criteria defined by the HEI they apply for admission.

8.5.4.1 Study programs “Master of science” and “Master of arts”

The “Master of Science” or “Master of arts” study programs, that provide the graduates, respectively, with in-depth theoretical knowledge as well as with scientific research skills in a given field or in-depth theoretical and practical knowledge in the fields of arts, are offered following first cycle studies with not less than 120 ECTS credits, normal duration of 2 academic years and belong to 7th AQF level.

të thelluara, teorike dhe praktike, në fushën e arteve, ofrohen në vijim të ciklit të parë dhe realizohen me jo më pak se 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe i përkasin nivelit 7 të KSHK-së.

Kriter pranimi në programet “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

IAL-të mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”.

Studimet “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer, ndërsa në përfundim të studimeve “Master i arteve” lëshohet diplomë “Master i arteve” në fushën e arsimimit të kryer, të cilat mundësojnë vijimin e studimeve në ciklin e tretë të studimeve.

8.5.4.2 Programet e studimeve “Master profesional”
Programet “Master profesional”, të cilat pajisin të diplomuarit, njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar, ofrohen në vijim të ciklit të parë dhe organizohen me 60 ose 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale, respektivisht, 1 ose 2 vite akademike dhe i përkasin nivelit 7 të KSHK-së.

Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.

Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”.

8.5.5 Studimet e ciklit të tretë

Programet e studimit të ciklit të tretë të studimeve, të cilat i korrespondojnë nivelit 8 të KSHK-së, përfshijnë programet e studimeve “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës.

Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Masteri shkencave” ose “Master i arteve” dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga IAL-ja përkatëse.

Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të

An admission criterion in the “Master of science” study programs is the knowledge by the candidates of one of the five foreign languages of the European Union: English, French, German, Italian, Spanish, certified through internationally recognized tests, as by provisions in the respective bylaw of the minister responsible for education. If the individual has obtained a degree in a study program conducted in one of these languages, the obtained diploma serves as proof of the fulfillment of this criterion.

HEIs may recognize credits obtained in a “Professional master” study program, with the aim of transferring them in a “Master of science” study program.

“Master of science” studies are finalized with a thesis and at the end of these studies a degree in “Master of science” in the respective field of the study is issued, meanwhile at the end of a “Master of arts” study, a degree in “Master of arts” in the respective field of the study is issued. Both of them give access to third cycle studies.

8.5.4.2 “Professional Master” study programs

The “Professional Master” study programs, that equip the graduates with in depth professional knowledge in a specific field, are offered following first cycle studies with not less than 60 or 120 ECTS credits, normal duration of 1 or 2 academic years, respectively, and belong to 7th AQF level.

The “Professional Master” second cycle studies are finalized with a final examination or a graduation thesis and in conclusion, the “Professional Master” degree is issued in the educational field completed.

The higher education institutions may recognize credits obtained in the “Professional Master” study programs of the second cycle with the aim of transferring the latter into the “Master of Science” study programs.

8.5.5 Third cycle studies

The third cycle study programs, that belong to 8th AQF level, include the “Executive Master” study programs, the long-term specialization study programs as well as the Doctoral studies.

The admission in the third cycle study programs is possible for the candidates who have obtained a degree “Master of Science” or “Master of Arts” and meet the admission criteria defined by respective HEI.

An admission criterion in the third cycle study programs is the knowledge by the candidate of one of the five foreign languages of the European Union: English, French, German, Italian, Spanish, certified through internationally recognized tests, as by provisions in the respective bylaw of the minister responsible for education. If the individual

tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individ ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

8.5.5.1 Programet e studimeve të doktoratës

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore e IAL-së. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre dhe jo më shumë se pesë vite akademike.

Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur, në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një IAL tjetër apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.

Në përfundim të studimeve të doktoratës dhe të plotësimit të kriterëve përkatës të përcaktuara me VKM lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

Institucionet e arsimit të lartë vendosin kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor.

8.5.5.2 Programet e studimeve “Master ekzekutiv”

Programet e studimeve “Master ekzekutiv” ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, organizohen me 60 ose 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje normale, përkatësisht 1 ose 2 vite akademike. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma “Master ekzekutiv” në fushën e arsimimit të kryer.

8.5.5.3 Programet e studimeve specializuese afatgjata

Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se 2 vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite ECTS. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë specializimi” në fushën përkatëse të programit të studimit.

8.5.6 Programet e studimeve të formimit të vazhduar

has obtained a degree in a study program conducted in one of these languages, the obtained diploma serves as proof of the fulfillment of this criterion.

8.5.5.1 Doctoral study programs

The Doctoral studies are built upon individual programs for independent training of candidates in scientific research in the fields defined by the basic or main HEI units. They are based on research and creative activities. The doctoral studies last for not less than three and not more than five academic years.

The doctoral studies are conducted on a full-time basis near the basic unit or on a prolonged time basis in those cases when the doctorate candidate is employed as an academic staff in another HEI or as research staff in an institution of basic or applied research.

When the doctorate studies are conducted in cooperation between institutions of higher education, parts of the research process may be developed within the cooperating institutions.

At the end of doctoral studies and fulfillment of the respective criteria specified in DCM, the degree of scientific grade “Doctor” is issued.

The higher education institutions establish criteria for the annual assessment of the progress of candidates and for the continuation of the research project.

8.5.5.2 “Executive Master” study program

The “Executive Master” study programs offer a high level of scientific and professional education. They are offered with 60 or 120 ECTS credits and normal duration, respectively, of 1 or 2 academic years. They are finalized with a graduation thesis and in conclusion the “Executive Master” degree is issued in the educational field completed.

8.5.5.3 The long-term specialization study programs

The long-term specialization study programs are programs of professional training that offer special professional knowledge. They have a duration of not less than 2 academic years and are offered with not less than 120 ECTS credits. They are finalized with the training examination or with a graduation thesis and at the end a “Specialization Diploma” is issued in the relevant educational field completed.

8.5.6 Lifelong Learning Programs

The institutions of higher education may offer continuous education programs, as lifelong learning education. These programs aim at complementing, deepening and consolidating of knowledges and can be offered as qualification or requalification courses, summer schools and similar activities. The continuous education study programs assist the individuals in their qualification progress and

Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit dhe të aftësive profesionale.

Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi bazë përgjegjëse, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, nëse kanë kompetencë, sipas kuarit ligjor për profesionet e rregulluara dhe bëhen publike nga njësi kryesore e IAL-së.

Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, institucionet e arsimit të lartë lëshojnë certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me këtë ligj.

Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë edhe kurse përgatitore për programet e studimeve që organizojnë.

8.6 Programet e përbashkëta të studimeve

Një IAL ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit mund të ofrojë programe të përbashkëta të studimit. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.

8.7 Sistemi i vlerësimit dhe shpërndarja e notave kaluese

Vlerësimi i dijeve në arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë bëhet me nota nga 1 deri në 10. Nota më e lartë është 10 dhe nota minimale kaluese është 5.

8.8 Ndjekja e një programi të dytë studimi dhe transferimi

Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël.

Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga kjo rregull nxënësit dhe studentët e shkëlqyer.

Transferimi i studimeve lejohet midis programeve të të njëjtut cikël studimi në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik, brenda të njëjtut institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta (*short cycle*) të nivelit 5 të KSHK-së mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që korrespondon me nivelin 6 të KSHK-së, sipas kritereve të përcaktuara nga IAL-ja.

Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në institucionin

profesional skills.

The structure of these programs, their duration and credits are determined independently from each responsible basic unit, in collaboration with the line ministries, if they have competencies, as by legal framework for regulated professions, and they are made public by the main HEI unit.

At the end of the continuous education studies and training programs, HEIs issue the relevant certifications, which are registered in accordance with the aforementioned law.

HEIs may also offer preparatory courses for the study programs that they offer.

8.6 Joint study programs

A HEI or any of its main unit, in cooperation with one or several other institutions of higher education, public or non public, in Albania or abroad, may offer joint study programs.

At the end of these studies a joint degree, double or multiple degree, is issued by the participating institutions.

8.7 The assessment system and passing grade distribution

The assessment of the knowledges in higher education in the Republic of Albania is done with grades from 1 to 10. The highest grade is 10 and the lowest passing grade is 5.

8.8 Attendance of a second study program and transfer of studies

Individuals, who have completed a study program, have the right to attend a second study program of the same cycle.

The student cannot be registered, at the same time, in more than one study program. Exceptions to this rule are excellent pupils and students.

Transfer of studies is permitted between programs of the same study cycle in the same or similar study fields and at the beginning of the academic year only, within the same institution or in a different HEIs.

Credits accumulated during study programs with professional nature (short cycle) of the 5th AQF level, can be transferred to first cycle studies, corresponding to the 6th AQF level, according to the criteria set by the HEI.

The decision on the full or partial recognition of the credits acquired by a student who is going to be transferred, with the purposes of continuing the studies in the host HEI, is taken by the relevant commission set up by the HEI's basic unit.

Study periods and study program obligations, completed in other domestic or foreign institutions, are recognized in view of continuing of the education in the same or similar study program.

pritis të arsimit të lartë, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë e IAL-së.

Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja kryhet nga IAL-ja, të cilit i është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve.

8.9 Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato “Master ekzekutiv” të ciklit të tretë, shoqërohen me suplementin e diplomës, i cili lëshohet automatikisht nga IAL-ja dhe pa pagesë.

Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga IAL-ja, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe në regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe për kërkimin shkencor, që mbahet në QSHA. IAL-të mund të lëshojnë diploma dhe certifikata vetëm konform formës së regjistruar dhe depozituar në QSHA.

IAL-të nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, kur kjo humbet apo dëmtohet, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.

8.10 Kohëzgjatja e studimeve

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritis.

Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e tij.

8.11 Gjuha e studimeve

Programet e studimit në IAL-të në Republikën e Shqipërisë ofrohen normalisht në gjuhën shqipe.

The recognition is carried out by the HEI, to which the application for continuation of studies has been submitted.

8.9 The issuance of diplomas, certificates and diploma supplement

At the end of the study program, the student is provided with a diploma or a certificate. The constituent elements, diploma form and registration procedures of the diploma form are defined by the ministry responsible for education.

Diplomas issued at the end of the first cycle, second cycle, and “Executive master” study programs of third cycle are accompanied by Diploma Supplement, which is issued by HEI automatically and free of charge.

Each form of diploma and of certificate, before being issued by the HEI, is registered in the state diplomas register and the in-state certificates register for higher education and scientific research, held at the CES. HEIs may issue diplomas and certificates only in compliance with the registered form which is deposited at the CES.

HEIs cannot issue a duplicate of diploma when the latter is lost or damaged, but they can issue an equivalent document in the form of an attestation equivalent with the diploma, which should include the name of the institution that has issued the diploma, the original diploma number, the date of issuance, the cycle and the title of the study program.

8.10 The duration of studies

The maximum duration of studies in a study program cannot be more than twice of the normal duration of the studies envisaged by the program, without taking into account the period of time when the student has suspended the studies.

The student, who fails to complete the studies within the maximum duration of the study program, has the right to apply for restarting studies, in the same study program or in a different study program. The student is subject to the criteria and procedures announced for admission in the study program of the receiving institution.

Credits collected by the student during the previous period of study can be transferred, by decision of the basic unit of the institution that accepts the student, according to the criteria set out in its regulation.

8.11 The language of study

Study programs offered by HEIs in the Republic of Albania are normally delivered in Albanian language. These programs may also be offered in one of the official languages of the European Union, which has to be approved in the respective act of licensing of the study program. The joint study programs offered in cooperation with foreign

Këto programe mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit European, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit. Përfshihen nga kjo rregull programet e përbashkëta të studimit të ofruara me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe programet e studimit që kanë për objekt mësimin e gjuhëve të huaja. Në rastin e programeve të studimit që ofrohen në gjuhë të huaj, studentët duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm për të kryer studime të larta, të përcaktuar nga IAL-ja, ofrues i programit të studimit. 8.12 Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK) KSHK-ja organizohet në 8 nivele që korrespondojnë me të njëjtat nivele të Kornizës Europiane të Kualifikimeve (KEK). Është në proces referencimi i KSHK-së me KEK-në. 8.13 Ushtrimi i një profesioni të rregulluar Profesionisti fiton të drejtën për të ushtruar një profesion të rregulluar, pasi ka marrë diplomën për kualifikimin përkatës, ka kryer me sukses praktikën profesionale dhe provimin e shtetit, si dhe pasi regjistrohet në urdhrin profesional përkatës. Nëse nuk është ngritur urdhri profesional dhe deri në ngritjen e tij, kompetencat përkatëse ushtrohen nga ministria kompetente që mbulon profesionin përkatës.	HEIs and the study programs which objective is learning of a foreign language are excluded from this rule. In the case of study programs offered in a foreign language, students must demonstrate the knowledge of the relevant foreign language at the level required to complete the studies, as determined by the HEI that provides the study program. 8.12 Albanian Qualifications Framework (AQF) The AQF is organized in 8 levels corresponding to the same levels as the European Qualifications Framework (EQF). It is in the process of referencing the AQF with KEK. 8.13 Pursuing a regulated profession The professional is entitled to exercise a regulated profession after having obtained the diploma for the relevant qualification, has successfully completed the professional practice and state exam, as well as have being registered in the relevant Professional Order. If the Professional Order has not been established, and until its establishment, the relevant powers are exercised by the competent ministry covering the relevant profession.
--	---